



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/05
Datë: 19.03.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, bazuar në nenin 125 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Republikës së Kosovës, nenet 6 dhe 52 të Marrëveshjes Kornizë IPA III, si dhe në nenet 5, 25-27, 32 dhe 36 të Marrëveshjes ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Republikës së Kosovës mbi Aranzhimet Specifike për Zbatimin e Mbështetjes së Unionit për Kosovën në kuadër të Instrumentit për Reforma dhe Rritje, Qeveria e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 mars 2026, merr këtë:

V E N D I M

Vendim për Themelimin dhe Funksionimin e Sistemit për Zbatimin e Mbështetjes së Bashkimit Evropian për Kosovën, përmes Instrumentit për Reforma dhe Rritje Ekonomike për Ballkanin Perëndimor

Neni 1
Qëllimi i vendimit

1. Qëllimi i këtij vendimi është vendosja e sistemit kombëtar për zbatimin e mbështetjes së Bashkimit Evropian, përmes Instrumentit për Reforma dhe Rritje Ekonomike për Ballkanin Perëndimor (në tekstin e mëtejme, Instrumenti për Reforma, IR), përfshirë Agjendën e Reformave të Instrumentit për Reforma dhe Rritje Ekonomike (në tekstin e mëtejme, RA e IR), si dhe përcaktimi i fushëveprimit, përbërjes dhe metodave të punës së strukturave koordinuese ndër-institucionale të Qeverisë së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme, Qeverisë) për këtë instrument.

Neni 2

Koordinatori Kombëtar i Instrumentit për Reforma dhe Rritje

1. Z. Jeton Zulfaj, Këshilltar Politik i Kryeministrit, përmes këtij vendimi emërohet Koordinator Kombëtar i Instrumentit për Reforma dhe Rritje Ekonomike (në tekstin e mëtejme, KK i IR).
2. KK i IR shërben si autoriteti kryesor koordinues që vepron në emër të Qeverisë për të gjitha çështjet që lidhen me IR, përfshirë AR të IR.
3. KK i IR vepron si pika e vetme e kontaktit për Komisionin Evropian (në tekstin e mëtejme, KE) për të gjitha çështjet që lidhen me zbatimin e mbështetjes së BE-së për Kosovën përmes IR, përfshirë AR të IR.

4. KK i IR ushtron funksionet e parapara në nenin 5 të Marrëveshjes për Instrumentin (në tekstin e mëtejshëm, MI), si dhe këto funksione shtesë:
 - 4.1. Udhëheq, në emër të Republikës së Kosovës, dialogun e politikave të nivelit të lartë me KE-në mbi IR dhe AR të IR, si dhe i jep direktiva dhe drejtim punës së saj si përfituese për të kontribuar në Komitetin Monitorues të Instrumentit për Reforma (në tekstin e mëtejshëm, KM të IR), në përputhje me nenin 25 të MI dhe nenin 17 të këtij vendimi;
 - 4.2. Fton, sipas relevancës, partnerët për zhvillim, institucionet financiare ndërkombëtare dhe palët e tjera të interesuara, si organizatat e shoqërisë civile, organizatat që përfaqësojnë sektorin privat, partnerët socialë dhe autoritetet lokale, sipas relevancës, për të marrë pjesë në dialogun e politikave të nivelit të lartë me KE-në mbi IR, në pajtim me nenet 13 dhe 19 të këtij vendimi;
 - 4.3. Mbikëqyr zbatimin e AR të IR në nivelin politik, përfshirë lidhur me masat korrigjuese dhe projektet investuese në kuadër të IR dhe përmes autorizimit dhe kryerjes së kontrolleve në vendndodhjen e zbatimit për këtë qëllim, dhe i propozon rekomandimet përkatëse Komitetit Drejtues të Instrumentit të Reformës (në tekstin e mëtejshëm, KD të IR) për shqyrtim, në pajtim me nenet 3, 4, 8 dhe 18 të këtij vendimi;
 - 4.4. Inicion amendamentimin e AR të IR, nëse kërkohet nga KE, dhe ia dorëzon AR të IR, të amendamentuar, KE-së për shqyrtim, dhe draftin përfundimtar Qeverisë për miratim;
 - 4.5. Informon rregullisht Qeverinë dhe Kuvendin e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm, Kuvendin) mbi zbatimin e AR të IR dhe përmbushjen e detyrimeve të tjera në kuadër të IR;
 - 4.6. Inicion një vlerësim gjithëpërfshirës të zbatimit të AR të IR dhe arritjes së objektivave të IR, nëse kërkohet nga KE, dhe ia dorëzon raportin përfundimtar KD të IR dhe në mbledhje të Qeverisë për informim;
 - 4.7. Mbikëqyr zbatimin e projekteve investuese në kuadër të IR, në bashkëpunim me institucionet përkatëse, përfshirë lidhur me masat korrigjuese, dhe i propozon rekomandimet përkatëse KD të IR për shqyrtim, në pajtim me nenet 3, 4 dhe 18 të këtij Vendimi.
2. KK i IR mbështetet në ushtrimin e funksioneve të tij/saj nga institucioni kryesor kombëtar koordinues për IR, siç parashihet në nenin 3 të këtij vendimi.

Neni 3

Institucioni kryesor kombëtar koordinues i Instrumentit për Reforma dhe Rritje Ekonomike

1. Funksioni i institucionit kryesor kombëtar koordinues për IR, përfshirë AR të IR, ushtrohet nga Zyra e Kryeministrit (në tekstin e mëtejshëm, ZKM). Ajo e kryen këtë funksion nëpërmjet KK të IR, me përkrahjen e departamenteve të saj të mandatuar ligjërisht si institucioni kryesor kombëtar koordinues për integrimin evropian (në tekstin e mëtejshëm, ZKM/DIE), përkatësisht këtyre departamenteve:
 - 1.1. Zyra për Koordinimin e Procesit të Stabilizim-Asocimit (në tekstin e mëtejshëm, ZKPSA);
 - 1.2. Zyra e Kritereve Politike (në tekstin e mëtejshëm, ZKP);
 - 1.3. Zyra e Kritereve Ekonomike dhe Tregut të Brendshëm (në tekstin e mëtejshëm, ZKETB);
 - 1.4. Zyra e Politikave Sektoriale (në tekstin e mëtejshëm, ZPoS); dhe
 - 1.5. Zyra e Bashkëpunimit për Zhvillim (në tekstin e mëtejshëm, ZBZH).

2. KK i IR mbështetet në kryerjen e funksioneve të tij/saj nga ZKM/DIE, të cilat kryejnë këto detyra dhe përgjegjësi:

2.1. ZKPSA kryen këto detyra dhe përgjegjësi:

- 2.1.1. Koordinon në nivel të përgjithshëm aspektet horizontale të sistemit të IR;
- 2.1.2. Koordinon në nivel të përgjithshëm monitorimin e raportimin dhe përgatitjen e raporteve mbi IR dhe AR të IR, përfshirë përgatitjen e udhëzimeve e shabllojeve, në bashkëpunim me KE-në dhe institucionet zbatuese;
- 2.1.3. U ofron udhëzime dhe mbështetje metodologjike institucioneve zbatuese mbi monitorimin dhe raportimin;
- 2.1.4. I ofron KK të IR informata dhe dokumentacion të kërkuar nga KE gjatë vlerësimeve që kryhen nga ky i fundit në Kosovë në kuadër të IR;
- 2.1.5. Mbështet KK të IR në përgatitjen dhe organizimin e dialogut të politikave ndërmjet Kosovës dhe BE-së në kuadër të IR, përmes KM të IR, përfshirë konsultimet me organizatat e shoqërisë civile, organizatat që përfaqësojnë sektorin privat, partnerët socialë dhe autoritetet lokale, sipas relevancës;
- 2.1.6. Përgatit dhe organizon punën e strukturave koordinuese ndërinstitucionale të Qeverisë në kuadër të IR;
- 2.1.7. Mbështet zbatimin e Planit për Komunikim dhe Promovim të RA të IR (në tekstin e mëtejshëm, PKP i IR) dhe monitorimin e raportimit mbi këtë.

2.2. ZKP, ZKETB dhe ZPoS kryejnë këto detyra dhe përgjegjësi në kuadër të fushave të politikave të RA të IR që mbulojnë:

- 2.2.1. Bashkëpunojnë me institucionet zbatuese për të lehtësuar dhe mbështetur zbatimin e hapave të reformave dhe në kryerjen e kontroleve të cilësisë së të dhënave të raportuara gjatë periudhave të monitorimit, me qëllim të sigurimit të saktësisë dhe besueshmërisë së tyre;
- 2.2.2. Marrin pjesë në përgatitjen e raporteve të rregullta mbi zbatimin e RA të IR dhe lidhur me IR, në bashkëpunim me institucionet përkatëse zbatuese, përfshirë ofrimin e informatave dhe dokumentacionit të kërkuar nga KE për vlerësimet e tij;
- 2.2.3. I ofrojnë KK të IR informata dhe dokumentacion të kërkuar nga KE në vlerësimet që kryen në dhe për Kosovën në kuadër të IR;
- 2.2.4. Mbështesin KK të IR në përgatitjen dhe organizimin e punës lidhur me dialogun e politikave ndërmjet BE-së dhe Kosovës në kuadër të IR, përmes KM të IR;
- 2.2.5. Kryejnë kontrole dhe verifikime gjatë zbatimit të hapave të reformave të AR të IR raportojnë te KE mbi përmbushjen e tyre;
- 2.2.6. Përgatisin dhe organizojnë punën e strukturave koordinuese ndërinstitucionale të Qeverisë në kuadër të IR;
- 2.2.7. Përgatisin dhe organizojnë punën e mekanizmit të konsultimeve me organizatat e shoqërisë civile, organizatat që përfaqësojnë sektorin privat, partnerët socialë dhe autoritetet lokale, sipas relevancës;
- 2.2.8. Mbështesin zbatimin e PKP të RA të IR dhe monitorimin e raportimin mbi zbatimin e tij;
- 2.2.9. Sipas relevancës, marrin pjesë dhe ofrojnë mbështetje në përmbushjen e kushteve të përgjithshme për disbursimin e fondeve.

2.3. ZKP mbulon këto fusha dhe nënfusha të AR të IR:

- 2.3.1. Fushën e politikave 1: Qeverisja, Reforma e Administratës Publike dhe Menaxhimi i Financave Publike, përkatësisht nënfushën 1.1: Reforma e Administratës Publike; dhe

të gjitha nënfushat në kuadër të saj.

2.4. ZKETB mbulon këto fusha dhe nënfusha të AR të IR:

- 2.4.1. Fushën e politikave 1: Qeverisja, Reforma e Administratës Publike dhe Menaxhimi i Financave Publike, përkatësisht nënfushën 1.2: Menaxhimi i Financave Publike;
- 2.4.2. Fushën e politikave 3: Zhvillimi i Sektorit Privat dhe Mjedisi Afarist, përkatësisht të gjitha nënfushat në kuadër të saj; dhe
- 2.4.3. Fushën e politikave 4: Zhvillimi dhe Ruajtja e Kapitalit Njerëzor, përkatësisht të gjitha nënfushat në kuadër të saj.

2.5. ZPoS mbulon fushën e politikave 2: Tranzicioni i Gjellbër dhe ai Digjital, përkatësisht të gjitha nënfushat në kuadër të saj.

2.6. ZBZH mbështet KK të IR në punën që lidhet me komponentin financiar të IR, përfshirë punën përgatitore lidhur me kërkesat për pagesa, si dhe punën e strukturave koordinuese ndërinstitutionale lidhur me këtë. ZBZH, në veçanti:

- 2.6.1. Merr pjesë në përgatitjen e raporteve të rregullta mbi zbatimin e AR të IR dhe lidhur me IR, duke mbuluar aspektet që lidhen me kushtet e përgjithshme për përkrahje në kuadër të këtij instrumenti, në bashkëpunim me institucionet përkatëse zbatuese;
- 2.6.2. Përgatit kërkesat për pranimin e fondeve, deklaratat e garancisë, si dhe mbledh e kontrollon informatat dhe të dhënat e tjera të nevojshme për marrjen e transheve të fondeve të IR, dhe ia dorëzon tërë pakon e dokumenteve KK të IR;
- 2.6.3. Mbështet vlerësimet që kryhen në dhe për Kosovën nga ana e KE-së në kuadër të IR;
- 2.6.4. Shërben si pikë kontakti për MI;
- 2.6.5. Koordinon planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e projekteve investuese në kuadër të IR.

Neni 4

Institucionet zbatuese të Instrumentit për Reforma dhe Rritje Ekonomike

- 1. Institucionet zbatuese të IR janë institucionet e Qeverisë, përkatësisht ZKM dhe ministritë, si dhe institucionet e tjera shtetërore të Republikës së Kosovës, siç parashihet në Shtojcën 1 të RA të IR dhe në Shtojcën e këtij vendimi.
- 2. Secili institucion zbatues është përgjegjës për zbatimin e hapave të reformave nën përgjegjësinë e tij, si dhe për monitorimin dhe raportimin mbi këtë KK-së së IR-së dhe ZKM/DEI-së, si institucioni kryesor kombëtar koordinues përgjegjës për IR, përfshirë për qëllim të raportimit të KE-së. Secili institucion, gjithashtu, ia dorëzon KK të IR një deklaratë garancie, të nënshkruar nga autoriteti i tij më i lartë, në mbështetje të deklaratës së tij/saj të sigurisë që i dorëzohet KE-së për çdo cikël të raportimit gjashtëmuor.
- 3. Secili institucion zbatues ushtron funksionet e tij në zbatimin e hapave të reformave të RA të IR nën përgjegjësinë e tij përmes departamenteve/njësive përgjegjëse për koordinim dhe atyre përgjegjëse për zbatimin e hapave të reformave dhe lidhur me IR.

4. Funkcioni i koordinimit brenda secilit institucion zbatues ushtrohet nga Departamenti për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave (në tekstin e mëtejshëm, DIEKP), përkatësisht njësia ekuivalente, në bashkëpunim të ngushtë me Ministrin dhe Sekretarin e Përgjithshëm, përkatësisht autoritetet ekuivalente, si dhe me departamentet/njësitë përgjegjëse për zbatimin e hapave të reformave dhe Njësinë e Auditimit të Brendshëm (në tekstin e mëtejshëm, NJAB). Brenda fushëveprimit të mandatit të saj ligjor dhe këtij neni, ai koordinon këto aspekte në lidhje me hapat e reformave nën përgjegjësinë e institucionit të tij:
 - 4.1. Monitorimin dhe përcjelljen e zbatimit të hapave të reformave, përfshirë edhe Planin e Punës për zbatimin e AR të IR;
 - 4.2. Raportimin mbi zbatimin e hapave të reformave, sipas nevojës, përfshirë për raportet gjashtëmujore dhe ato vjetore që i dorëzohen KE-së nga ana e KK të IR;
 - 4.3. Ofrimin e përkrahjes KK të IR, përmes ZKM/DIE, për raportim KE-së, sipas kërkesës, mbi zbatimin e hapave të reformave;
 - 4.4. Parandalimin e financimit të dyfishtë gjatë gjithë zbatimit të hapave të reformave;
 - 4.5. Parandalimin e parregullsive, mashtrimit, korrupsionit dhe aktiviteteve të paligjshme që ndikojnë në interesat financiare të BE-së, përfshirë konfliktin e interesit, gjatë tërë zbatimit të hapave të reformave nën përgjegjësinë e saj;
 - 4.6. Pjesëmarrjen në kontrole dhe verifikime gjatë gjithë zbatimit të hapave të reformave, si dhe monitorimi dhe raportimi mbi kontrole dhe verifikime të tilla;
 - 4.7. Pjesëmarrjen në dialogun e politikave në kuadër të IR, përmes KM të IR, dhe në punën e strukturave koordinuese ndër-institucionale të Qeverisë në kuadër të IR, dhe përgatitjet për këtë qëllim;
 - 4.8. Kryerjen e verifikimeve në vendndodhjen e zbatimit lidhur me përmbushjen e hapave të reformave dhe qëndrueshmërinë, me qëllim sigurimin e respektimit të MI, dhe raportimin mbi këtë, sipas kërkesës;
 - 4.9. Projektet investuese në kuadër të IR, përkatësisht programimin, aplikimet, parakushtet për zbatimin e tyre, dhe monitorimin dhe raportimin;
 - 4.10. Ofrimin e mbështetjes institucionit në ushtrimin e funksioneve të tij në kuadër të IR dhe AR të IR;
 - 4.11. Pjesëmarrjen në zbatimin e PKP të AR të IR dhe në monitorimin dhe raportimin për këtë.
5. Funkcioni i zbatimit të hapave të reformave brenda secilit institucion zbatues ushtrohet nga departamentet/njësitë e tij që janë të mandatuara ligjërisht për fushat dhe nënfushat përkatëse të politikave, në bashkëpunim me departamentet/njësitë e institucioneve mbështetëse përgjegjëse për zbatimin e tyre, si dhe me Ministrin, Sekretarin e Përgjithshëm, DIEKP dhe NJAB, përkatësisht autoritetet dhe departamentet/njësitë ekuivalente. Brenda fushëveprimit të mandatit të tyre ligjor dhe këtij neni, ato kryejnë këto detyra dhe përgjegjësi:
 - 5.1. Zbatojnë hapat e reformave dhe përcjelljen e rregullt të kësaj përmes Planit të Punës për zbatimin e RA të IR, përfshirë organizimin e punës, përgatitjen dhe kryerjen e procedurave përkatëse, inicimin dhe organizimin e grupeve dhe ekipeve të punës, planifikimin dhe kërkimin e mbështetjes së jashtme, kërkimin e inicimit të aktiviteteve të prokurimit dhe ofrit të mbështetjes së nevojshme për këtë qëllim;
 - 5.2. Sigurojnë parandalimin e financimit të dyfishtë gjatë tërë zbatimit të hapave të reformave dhe raportimin për këtë, sipas nevojës;
 - 5.3. Sigurojnë parandalimin të parregullsive, mashtrimit, korrupsionit, konfliktit të interesit dhe çfarëdo aktiviteti tjetër të paligjshëm përgjatë tërë zbatimit të hapave të reformave, dhe raportimin për këtë, sipas nevojës;
 - 5.4. Raportojnë mbi zbatimin e hapave të reformave, sipas nevojës, përfshirë për raportet gjashtëmujore dhe ato vjetore që i dorëzohen KE-së;
 - 5.5. Bashkëpunojnë efektivisht me autoritetet dhe departamentet/njësitë përkatëse, përfshirë NJAB-në, në kryerjen e kontroleve e verifikimeve të brendshme dhe auditimeve gjatë tërë zbatimit të hapave të reformave, dhe për qëllimi të raportimit për këtë;

- 5.6. Marrin pjesë në dialogun e politikave në kuadër të IR, përmes KM të IR, dhe në punën e strukturave koordinuese ndërinstytucionale të Qeverisë në kuadër të IR, dhe përgatitjet për këtë;
 - 5.7. Projektet investuese në kuadër të IR, përkatësisht programimin, aplikimet, parakushtet për zbatimin e tyre, si dhe monitorimin dhe raportimin për këtë;
 - 5.8. Marrin pjesë në zbatimin e PKP të RA të IR dhe në monitorimin dhe raportimin për këtë.
6. Në përputhje me Shtojcën 1 të AR të IR dhe shtojcën e këtij vendimi, ZKM dhe institucionet e tjera të Qeverisë bashkëpunojnë me institucione të tjera në ushtrimin e funksioneve të tyre në kuadër të IR dhe AR të IR.

Neni 5

Ministria përgjegjëse për financa

1. Ministria përgjegjëse për financa kryen këto detyra dhe përgjegjësi:
 - 1.1. Lidh Marrëveshjen e Huas (në tekstin e mëtejshëm, MH) me KE-në dhe vepron si përfaqësuese e Qeverisë në të gjitha aranzhimet që rrjedhin prej saj;
 - 1.2. Zbaton dhe lehtëson transferet financiare që lidhen me IR dhe mirëmban të dhënat financiare;
 - 1.3. Siguron respektimin e rregullave për menaxhimin financiar dhe llogaridhënie;
 - 1.4. Koordinon punën e institucioneve vendase në kuadër të rjetit të Shërbimit Koordinues Kundër Mashtrimit (AFCOS) dhe lehtëson bashkëpunimin administrativ me Gjykatën Evropiane të Auditorëve (në tekstin e mëtejshëm, GJEA) dhe Zyrën Evropiane Kundër Mashtrimit (në tekstin e mëtejshëm, OLAF) lidhur me aktivitetet e auditimit dhe verifikimit.

Neni 6

Sistemi i kontrollit të brendshëm dhe auditimit në kuadër të Instrumentit për Reforma dhe Rritje Ekonomike

1. Kosova siguron një sistem efektiv të kontrollit të brendshëm gjatë tërë zbatimit të AR të IR, sipas legjislacionit kombëtar në fuqi.
2. Secili institucion zbatues kryen kontrole dhe verifikime të brendshme gjatë tërë zbatimit të hapave të reformave nën përgjegjësinë e tij dhe monitoron dhe raporton mbi këtë në pajtim me legjislacionin përkatës kombëtar në fuqi, përmes këtyre strukturave dhe autoriteteve në kuadër të tij:
 1. Sekretarit të Përgjithshëm / autoritetit ekuivalent, në cilësinë e Zyrtarit Kryesor Financiar;
 2. Drejtorit / autoritetit ekuivalent të departamentit / njësisë ekuivalente përgjegjëse për zbatim;
 3. Udhëheqësit / autoritetit ekuivalent të divizionit / njësisë ekuivalente përgjegjëse për zbatim;
 4. Auditimit/auditorit të brendshëm.

3. Në fund të periudhës së zbatimit të një hapi reformash, institucioni përgjegjës dhe secili institucion mbështetës ia dorëzon ZKM/DEI një letër konfirmimi të kontrolleve dhe verifikimeve të brendshme – së bashku me tabelën e plotësuar të raportimit – jo më vonë se dy javë para dorëzimit të raportit të rregullt gjashtëmujor të KE. Kjo letër konfirmimi, e nënshkruar nga zyrtarët e përvijuar në paragrafin 6 të këtij neni, konfirmon që institucioni ka kryer kontrolle dhe verifikime të brendshme përgjatë tërë zbatimit të hapit të reformave, si dhe përmbledh gjetjet e mangësive të identifikuara në këtë proces, nëse ka të tilla.
4. Strukturat dhe autoritetet institucionale përgjegjëse për kontrollet dhe verifikimet e brendshme të specifikuara në paragrafin 2 të këtij neni kryejnë detyrat e tyre në bashkëpunim të ngushtë me ministrin dhe DIEKP-në, përkatësisht autoritetet dhe njësitë ekuivalente të institucionit, si dhe me NJQH-në dhe ZKM/DIE.
5. Institucioni kryesor kombëtar koordinues përgjegjës për IR kryen një verifikim të plotësisë së informatave të raportuara dhe shtojcave të tij të pranuar nga institucionet zbatuese dhe mund të kryejë kontrolle dhe verifikime shtesë, sipas nevojës.
6. Në pajtim me legjislacionin kombëtar për menaxhimin e financave dhe kontrollin e brendshëm, ministria përgjegjëse për financa siguron që të vendoset një sistem efektiv dhe efikas i kontrollit të brendshëm. Kjo ministri, nëpërmjet NJQH-së së saj, është institucioni kryesor koordinues për sistemin e auditimit të brendshëm përgjatë tërë zbatimit të AR të IR.
7. Në këtë cilësi, NJQH përgatit përmbledhjen e auditimeve të specifikuar në këtë nen dhe ia dorëzon atë KK të IR jo më vonë se dy javë para dorëzimit të raportit të rregullt gjashtëmujor KE-së. Ajo e përgatit një përmbledhje të tillë në bashkëpunim të ngushtë me NJAB-të e institucioneve përkatëse zbatuese dhe ZKM/DEI. NJAB e secilit institucion zbatues bashkëpunon me NJQH-në në ushtrimin e këtij funksioni dhe ia ofron asaj të gjitha informatat dhe dokumentacionin e nevojshëm.
8. Në ushtrimin e funksionit të saj sipas këtij neni, NJQH ndërmerr aktivitete të tjera për NJAB-të, përfshirë ato ngritjen e kapaciteteve. Ajo e bën këtë në bashkëpunim të ngushtë me ZKM/DEI dhe njësitë dhe autoritetet përkatëse të institucioneve zbatuese.
9. Të gjitha institucionet publike që marrin pjesë në sistemin e menaxhimit, zbatimit dhe kontrollit të AR të IR:
 - 9.1. Zbatojnë procedura transparente, jodiskriminuese dhe llogaridhënëse, sipas legjislacionin kombëtar dhe kërkesave të IR mbi ndarjen e detyrave, kontrollet e brendshme, dhe procedurat për të parandaluar, zbuluar, raportuar dhe korrigjuar parregullsitë dhe mashtrimet;
 - 9.2. Sigurojnë që të gjitha të dhënat financiare të jenë të plota, të sakta dhe të besueshme;
 - 9.3. Mbajnë të dhëna dhe dokumentacionin e duhur për të gjitha operacionet e financuara në kuadër të IR, përfshirë gjurmueshmërinë e transaksioneve financiare;
 - 9.4. Sigurojnë ligjshmërinë dhe rregullsinë e të gjitha transaksioneve, dhe mirëmbajnë menaxhim të shëndoshë financiar të fondeve të BE-së dhe fondeve kombëtare në bashkëfinancim për investimet përkatëse në përputhje me parimet e menaxhimit të shëndoshë të financave.
10. Të gjitha fondet në kuadër të IR si instrument financiar u nënshtrohen auditimeve nga Gjykata Evropiane e Auditorëve, Zyra Evropiane Kundër Mashtrimit (OLAF) dhe palë të tjera të autorizuar sipas MI dhe MH. Shërbimi Koordinues Kundër Mashtrimit, i themeluar në ministrinë përgjegjëse për financa, lehtëson bashkëpunimin, koordinimin dhe shkëmbimin efektiv të informatave me OLAF-in, KE-në dhe EPPO-në brenda kufijve të kompetencave të tyre përkatëse.

Neni 7

Përbushja e kushteve të përgjithshme për mbështetje në kuadër të IR

1. Kosova siguron përbushjen e vazhdueshme të kushteve të përgjithshme për mbështetje në kuadër të IR përgjatë tërë zbatimit të AR të IR, dhe KK i IR, me përkrahjen e ZKM/DIE, monitoron dhe i raporton rregullisht KE-së për këtë. Në përputhje me MI, këto kushte janë si më në vijim:
 - 1.1. Zhvillimet dhe rreziqet makroekonomike;
 - 1.2. Zhvillimet dhe rreziqet fiskale;
 - 1.3. Reformat e menaxhimit të financave publike dhe
 - 1.4. Transparenca dhe mbikëqyrja e buxhetit.
2. Në përputhje me legjislacionin kombëtar në fuqi, ministria përgjegjëse për financa është institucioni përgjegjës për përbushjen e kushteve të përgjithshme për mbështetje në kuadër të IR, dhe i raporton KK të IR për këtë. Ajo e ushtron këtë funksion në bashkëpunim me ZKM/DIE, si dhe me institucionet zbatuese, sipas nevojës.
3. Ministria përgjegjëse për financa e ushtron këtë funksion nëpërmjet këtyre njësive institucionale:
 - 3.1. Departamentit të Politikave Ekonomike, përgjegjës për zhvillimet dhe rreziqet makroekonomike, përfshirë zbatimin dhe monitorimin e raportimin mbi Programin për Reforma në Ekonomi, si dhe për zhvillimet dhe rreziqet fiskale;
 - 3.2. Departamentit për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave, që mbulon reformat e menaxhimit të financave publike; dhe
 - 3.3. Thesarit të Shtetit dhe Departamentit të Buxhetit, përgjegjës për transparencën dhe mbikëqyrjen e buxhetit.
4. Ministria përgjegjëse për financa ia dorëzon informatat mbi përbushjen e kushteve të përgjithshme për financim ZKM-së, përkatësisht ZBZH-së.

Neni 8

Sistemi i raportimit për Instrumentin për Reforma dhe Rritje Ekonomike dhe afatet përkatëse

1. KK i IR, në emër të Republikës së Kosovës si Përfituese e IR, i dorëzon KE-së raporte të rregullta mbi zbatimin e AR të IR, çdo gjashtë muaj, si dhe mbi kushtet e përgjithshme për mbështetje, çështjet ndër-sektoriale dhe mbi reformat relevante në sistemin e saj të kontrollit dhe atë të auditimit të brendshëm, çdo vit. Ai/ajo gjithashtu raporton më shpesh, nëse kërkohet nga KE, në përputhje me afatet dhe shabllonet e paraparë sipas MI.
2. KK i IR, me mbështetjen e ZKM/DIE, inicion përgatitjen e raporteve gjashtëmujore, vjetore dhe përfundimtare mbi IR duke ua dërguar kërkesat përkatëse njësive koordinuese (DIEKP-ve ose njësive të tjera të ngarkuara me këtë rol në institucionet e tyre) të institucioneve zbatuese. Për këtë qëllim, ZKM/DIE nxjerr udhëzime të detyrueshme dhe dokumente të tjera procedurale, bazuar në udhëzimet dhe dokumentet procedurale përkatëse të nxjerra nga KE për këtë qëllim. ZKM/DIE gjithashtu mund të zhvillojë mjete të detyrueshme të TI-së, siç është një platformë online, për këtë qëllim.

3. Në përgjithësi, raportimi për raportet gjashtë mujore mbi zbatimin e Marrëveshjes AR të IR kryhet sipas përgjegjësisë të ndara si në vijim:
 - 3.1. Institucioni përgjegjës për zbatimin e hapit të reformave sipas Shtojcës 1 të AR të IR, përkatësisht departamenti/njësia e tij përgjegjëse, raporton mbi zbatimin e tij;
 - 3.2. Në rastet kur përgjegjës për një hap të reformave është më tepër se një institucion, institucioni udhëheqës, përkatësisht i pari në listë, ose ai që është përgjegjës për pjesën më të madhe të hapit të reformave, koordinon raportimin, ndërsa institucionet e tjera janë institucione mbështetëse;
 - 3.3. Departamenti/njësia përgjegjëse e institucionit përgjegjës përgatit draftin e tabelës raportuese (*fiche-it*); në rastet e përcaktuara në nën-paragrafin 3.2 të këtij paragrafi, kjo bëhet nga departamenti/njësia përgjegjëse e institucionit udhëheqës;
 - 3.4. Departamenti/njësia përgjegjëse e institucionit udhëheqës ia dorëzon draftin e tabelës raportuese DIEKP-së/njesisë ekuivalente të institucionit udhëheqës, duke njoftuar edhe departamentin/et/njësitë/ë përgjegjëse të institucionit/eve mbështetëse/e;
 - 3.5. DIEKP/njësia ekuivalente e institucionit udhëheqës kontrollon cilësinë e draftit të tabelës raportuese dhe ia dorëzon atë ZKM/DIE-së; nëse DIEKP/njësia ekuivalente jep komente gjatë kontrollit të cilësisë, ato i dërgohen departamentit/njesisë përgjegjëse të institucionit udhëheqës dhe adresohen nga ai.
4. Në përgjithësi, raportimi për raportet vjetore mbi IR kryhet sipas përgjegjësisë të ndara si në vijim:
 - 4.1. Përmbledhje e zbatimit të RA të IR gjatë periudhës raportuese – kjo pjesë përgatitet nga ZKM/DIE si institucioni kryesor përgjegjës, bazuar në kontributet e institucioneve përkatëse mbështetëse sipas mandatit të tyre ligjor;
 - 4.2. Kontributi në progresin e arritur në zbatimin e objektivave të përgjithshme dhe atyre specifike të IR – kjo pjesë përgatitet nga ZKM/DIE si institucioni kryesor përgjegjës, bazuar në kontributet e institucioneve përkatëse mbështetëse, përkatësisht të institucioneve zbatuese të AR të IR që mbulojnë fushat dhe nënfushat përkatëse sipas mandatit të tyre ligjor;
 - 4.3. Përditësim mbi vendosjen dhe funksionimin e sistemit të kontrollit dhe auditimit të brendshëm – kjo pjesë përgatitet nga NJQH në kuadër të MF si institucioni kryesor përgjegjës për këtë komponent, bazuar në kontributet e NJAB-ve të institucioneve zbatuese të AR të IR;
 - 4.4. Çështjet ndër-sektoriale – kjo pjesë përgatitet nga ZKM/DIE si institucioni kryesor përgjegjës, bazuar në kontributet e institucioneve përkatëse mbështetëse sipas mandatit të tyre ligjor;
 - 4.5. Përmbushja e kushteve të përgjithshme për mbështetje në kuadër të IR – kjo pjesë përgatitet nga departamentet/njësitë përkatëse të ministrisë përgjegjëse për financa, bazuar edhe në kontributet e institucioneve përkatëse mbështetëse sipas mandatit të tyre ligjor;
 - 4.6. Informata të tjera që KE mund t'i konsiderojë relevante për të kryer vlerësimin e përmbushjes së kritereve dhe kushteve përkatëse në kuadër të IR – këto informata përgatiten nga ZKM/DIE si institucioni kryesor përgjegjës, bazuar në kontributet e institucioneve përkatëse mbështetëse sipas mandatit të tyre ligjor.
5. KK i IR, me mbështetjen e ZKM/DIE, monitoron rregullisht zbatimin e AR të IR dhe, përfshirë përmes dialogut të politikave për IR dhe strukturave koordinuese ndër-institucionale të Qeverisë. Institucioneve zbatuese gjithashtu u kërkohet të raportojnë drejtpërsëdrejti për këtë të paktën çdo muaj dhe çdo tre muaj, përfshirë edhe përmes mjeteve të TI-së, sipas nevojës.

6. Secili institucion zbatues kryen rregullisht monitorim dhe raportim të brendshëm të zbatimit të hapave të reformave, ose pjesëve të hapave të reformave nën përgjegjësinë e tij, në përputhje me hierarkinë e vendimmarrjes, përkatësisht nga departamenti/njësia përgjegjëse për zbatim, e koordinuar nga DIEKP/njësia ekuivalente, nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të Sekretarit të Përgjithshëm/autoritetit ekuivalent, në bashkëpunim të ngushtë me Ministrin/autoritetin ekuivalent.
7. KK i IR, i mbështetur nga ZKM/DIE si institucioni kryesor koordinues për IR, informon kabinetin qeveritar, të paktën çdo tre muaj, mbi zbatimin e AR të IR dhe për çështje të tjera që lidhen me IR që janë të rëndësishme për t'u adresuar në këtë nivel.
8. KK i IR, i mbështetur nga ZKM/DIE si institucioni kryesor koordinues për IR, informon rregullisht Kuvendin mbi zbatimin e AR të IR dhe për çështje të tjera që lidhen me të e që janë të rëndësishme për t'u trajtuar në këtë nivel, në veçanti për projektligjet e parapara në AR të IR. Ai/ajo e bën këtë përmes Komisionit për Integrimin Evropian dhe në forma të tjera, siç rregullohet nga Rregullorja e Punës së Kuvendit në lidhje me të gjitha politika që zbatohen nga Qeveria. KK i IR gjithashtu e informon dhe konsultohet me Kuvendin, sipas nevojës, në kuadër të dialogut e politikave të nivelit të lartë me KE-në përmes KM të IR.

Neni 9

Kërkesat për lirim të fondeve

1. Bazuar në arritjen e hapave, të raportuara në raportet gjashtëmujore, KK i IR i nënshkruan kërkesat për lirim të fondeve dhe ia dorëzon ato KE-së, si pjesë e raportimeve gjashtëmujore mbi zbatimin e AR të IR. Këto kërkesa përgatiten nga ZBZH.
2. ZBZH mbledh të gjitha dokumentet e kërkuara sipas MI, dhe KK i IR ua përcjellë kërkesën e nënshkruar me dokumentet bashkëngjitur përfaqësuesve të BE-së. Secilën kërkesë përmban raportet mbi kushtet e pagesave në lidhje me hapat e reformave të parapara në AR të IR për periudhën përkatëse të raportimit, dhe dorëzohet jo më vonë se 15 ditë pas përfundimit të periudhës raportuese.
3. Kërkesa përfshin formularin shabllon sipas MI, një tabelë raportuese të plotësuar për secilin hap të përmbushur me dëshmitë mbështetëse, një Deklaratë të Garancisë, të nënshkruar, një përmbledhje të auditimeve dhe verifikimeve përkatëse, dhe çfarëdo dokumentacion shtesë të kërkuar për të justifikuar përmbushjen e hapave, përfshirë akte ligjore dhe strategji të miratuara, raporte, certifikata të përfundimit, ose dokumente të tjera relevante.
4. Aty ku ka raste të tilla, ZBZH specifikon nëse është marrë përkrahje nga ndonjë program tjetër i BE-së ose partnerë të tjerë për zhvillim për zbatimin e cilitdo hapi të reformave, dhe shpjegon aranzhimet në fuqi për të parandaluar financimin e dyfishtë.

Mbledhja e të dhënave dhe transparenca

1. KK i IR, me mbështetjen e ZKM/DIE, dhe institucionet zbatuese, zotohet për transparencë dhe llogaridhënie në zbatimin e IR.
2. Qeveria publikon të dhëna të azhuruara mbi pranuesit përfundimtarë që marrin shuma fondesh që tejkalojnë ekuivalentin e vlerës së gjithmbarshme prej 50,000 eurosh gjatë një periudhe prej katër vitesh, për zbatimin e reformave dhe investimeve të specifikuara në IR.
3. Institucionet zbatuese përditësojnë të dhënat e përmendura në paragrafin 3 të këtij neni të paktën një herë në vit.
4. Për pranuesit përfundimtarë të përmendur në paragrafin 3 të këtij neni publikohen, në format të lexueshëm me makinë në një ueb-faqe, sipas renditjes së shumave totale të fondeve të pranuar:
 - 1.1. Për personat juridikë, emri i plotë ligjor i pranuesit dhe numri identifikues i TVSH-së ose numri identifikues tatimor, kur është në dispozicion, ose ndonjë e dhënë tjetër specifike identifikuese të përcaktuar nga legjislacioni i zbatueshëm për personin juridik.
 - 1.2. Për personat fizikë, emri/at dhe mbiemri/at i/e pranuesit/ve të fondeve.
 - 1.3. Shuma e pranuar nga pranuesit e fondeve dhe reformat e investimet në kuadër të AR të IR në zbatimin e të cilave kontribuon kjo shumë.
2. Informatat e përmendura në paragrafin 3 të këtij neni nuk publikohen kur zbulimi i tyre rrezikon të kërcënojë të drejtat dhe liritë e përfituesve përfundimtarë në fjalë ose të dëmtojë seriozisht interesat e tyre komerciale. Megjithatë, këto informata i vihen në dispozicion KE-së dhe autoritetit përkatës të auditimit.
3. KK i IR, me përkrahjen e ZKM/DIE, ia përcjell KE-së, në format elektronik, të paktën një herë në vit, të dhënat mbi përfituesit përfundimtarë të përmendur në paragrafin 3, duke përdorur formatin XML sipas një shablloni të ofruar nga KE.
4. ZKM/DIE i ofron KE-së të gjitha informatat dhe të dhënat e nevojshme për krijimin e Platformën Monitoruese për IR (*RGF Scoreboard*) të KE-së dhe përditësimin e saj dy herë në vit, në përputhje me nenin 21, paragrafin 8, të MI. Këto informata përfshijnë raporte në kohë dhe të sakta mbi të arriturat në zbatimin e AR të IR. KK i IR, me përkrahjen e ZKM/DIE, bashkëpunon plotësisht me KE-në për të siguruar që Platforma Monitoruese të jetë funksionale dhe e qasshme për publikun përmes interneti.
5. KK i IR, me përkrahjen e ZKM/DIE, siguron që pajtohet që AR e IR dhe kërkesat për lirinë e fondeve të vihen në dispozicion të publikut jo më vonë se kërkesa e parë për lirinë e fondeve.
6. Dokumentet në kuadër të IR janë dokumente publike, dhe sigurohet qasja e publikut në to në pajtim me legjislacionin kombëtar që rregullon qasjen në dokumente publike.
7. Legjislacioni dhe politikat që do të miratohen në kuadër të zbatimit të hapave të reformave të AR të IR konsultohen ndërmjet institucioneve të përfshira dhe me OSHC-të dhe palët e tjera të interesuara në pajtim me legjislacionin kombëtar në fuqi që rregullon konsultimet paraprake dhe ato publike. Në përputhje me këtë legjislacion, konsultimet e tilla menaxhohen nga institucionet përkatëse zbatuese.

Neni 11

Konsultimet me shoqërinë civile, partnerët për zhvillim dhe palët e tjera të interesuara

1. ZKM/DIE, në bashkëpunim me KE-në dhe institucionet zbatuese, organizon konsultime me organizatat e shoqërisë civile, organizatat që përfaqësojnë sektorin privat, partnerët socialë dhe autoritetet lokale, sipas relevancës, si dhe me partnerët për zhvillim dhe institucionet financiare ndërkombëtare, sipas nevojës.
2. Konsultimet kryhen në kuadër të dialogut të politikave të IR dhe strukturave koordinuese ndërinstitucionale të Qeverisë të vendosura sipas MI dhe këtij vendimi.
3. KK i IR i fton palët e interesuara të specifikuara në paragrafin 1 të këtij neni në KM të IR dhe në takimet e strukturave koordinuese ndërinstitucionale të Qeverisë në kuadër të IR. Ai/ajo punon drejtpërsëdrejti në konsultime me palë të tilla të interesit, në pajtim me MI.

Neni 12

Plani i Komunikimit dhe Promovimit i Instrumentit për Reforma dhe Rritje Ekonomike

1. ZKM/DIE, në bashkëpunim me institucionet zbatuese përgatit, zbaton dhe monitoron një Plan Komunikimi dhe Promovimi për AR të IR (PKP i AR të IR).
2. ZKM/DIE bashkëpunon për këtë edhe me palët e tjera të interesuara, përfshirë KE-në dhe Zyrën e BE-së në Kosovë.
3. KK i IR i raporton KE-së për zbatimin e PKP të AR të IR çdo vit.

Neni 13

Parandalimi i parregullsive, mashtrimit dhe korrupsionit

1. Të gjitha institucionet zbatuese, monitoruese dhe koordinuese që marrin pjesë në menaxhimin dhe zbatimin e RA të IR ndërmarrin masat e nevojshme për parandalimin, zbulimin, raportimin dhe korrigjimin e parregullsive, mashtrimit, korrupsionit, konfliktit të interesit dhe aktiviteteve të tjera të paligjshme, në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe MI.
2. Institucionet publike duhet të raportojnë të gjitha rastet e zbuluara të parregullsive, mashtrimit dhe korrupsionit tek autoriteti i caktuar në përputhje me procedurat ligjore kombëtare të vendosura.

Neni 14

Masat korigjuese dhe kthimi i fondeve

1. Nëse identifikohen parregullsi, keqpërdorime ose mosrespektim i kushteve të MI ose MH, zbatohen masa korigjuese pa vonesa, përfshirë kthimin e fondeve të shpenzuara në mënyrë jo të duhur, pezullimin e pagesave ose ndërprerjen e financimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe MI.
2. Në përputhje me nenin 14 të MI, Republika e Kosovës u jep të drejtat agjentëve të KE-së, OLAF-it, GJEA-së dhe PPE-së, brenda kufijve të mandateve të tyre përkatëse, për të kryer çfarëdo veprimi hetimor ose të auditimit, përfshirë verifikime ose auditime teknike, financiare dhe të sistemit, që ata mund ta konsiderojnë të nevojshme për të përcjellë zbatimin e AR të IR. Kjo përfshin vizitat në lokacione dhe ambiente ku zbatohen ose menaxhohen aktivitete të financuara nga IR, në të kaluarën, aktualisht ose në të ardhmen.
3. Republika e Kosovës ofron të gjithë informatat dhe dokumentet e kërkuara, përfshirë çfarëdo të dhënash në format elektronik, dhe ndërmerr të gjitha masat e nevojshme për të lehtësuar punën e personave të përmendur në paragrafin 2 të këtij neni të udhëzuar për të kryer auditime, kontrole në vendin e zbatimit, inspektime ose veprime të tjera hetimore, pa cenuar dispozitat në fuqi për mbrojtjen dhe sigurinë e të dhënave.

Neni 15

Komiteti Monitorues i Instrumentit për Reforma dhe Rritje Ekonomike

1. Komiteti Monitorues i Instrumentit për Reforma dhe Rritje Ekonomike ndërmjet BE-së dhe Kosovës (KM i IR) shërben si strukturë e përbashkët institucionale ndërmjet BE-së dhe Kosovës për dialog të politikave të nivelit të lartë ndërmjet palëve, në pajtim me MI.
2. KM i IR vlerëson shkallën dhe cilësinë e zbatimit të AR të IR dhe projekteve investuese në kuadër të IR, si dhe përmbushjen e objektivave të IR dhe detyrimeve të tjera që dalin nga MI dhe MH.
3. KK i IR është Bashkë-kryesues sipas detyrës zyrtare, në emër të Republikës së Kosovës si Përfitues, i KM të IR.
4. KK i IR, në rrethana të jashtëzakonshme, mund ta caktojë një zyrtar të Qeverisë, të rangut të lartë, për të bashkë-kryesuar mbledhje specifike të KM të IR në emër të tij/saj.
5. Anëtarët e KD të IR që përfaqësojnë Republikën e Kosovës janë zyrtarë të lartë të ZKM-së dhe ministrive të përfshira në zbatimin e AR të IR dhe në lidhje me IR, si dhe të atyre të përfshirë në lidhje me projektet e investimeve, kushtet e përgjithshme për mbështetje në kuadër të IR, çështjet ndër-sektoriale, kontrollin e auditimin, dhe aspekte të tjera.
6. Kur kërkohet sipas rendit të ditës, cilido Bashkë-kryesues fton zyrtarë të lartë, të niveleve ekuivalente, të institucioneve të pavarura të përfshira në zbatimin e AR të IR dhe në lidhje me IR, si dhe të atyre të përfshirë në lidhje me projektet investuese, kushtet e përgjithshme për mbështetje në kuadër të IR, çështjet ndër-sektoriale, kontrollin e auditimin, dhe aspekte të tjera, për të marrë pjesë në mbledhje.

7. KM i IR, në cilësinë e Bashkë-kryesuesit të KM të IR, fton përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, organizatave që përfaqësojnë sektorin privatë, të partnerëve socialë dhe autoriteteve lokale, sipas relevancës, si dhe të partnerëve për zhvillim dhe institucioneve financiare ndërkombëtare, sipas nevojës, për të marrë pjesë në takime.
8. KM i IR mban mbledhje të rregullta një herë në vit, me ftesë të njërit prej Bashkë-kryesuesve. Ai mund të mbledhet edhe më shpesh, në mbledhje *ad hoc*, me ftesë të njërit prej Bashkë-kryesuesve.

Neni 16

Strukturat koordinuese ndërinstitucionale të Qeverisë për Instrumentin për Reforma dhe Rritje Ekonomike

1. Strukturat koordinuese ndërinstitucionale të Qeverisë në kuadër të IR janë si në vijim:
 - 1.1. Këshilli Ministror për Integrim Evropian (në tekstin e mëtejshëm, KMIE), i cili vepron në cilësinë e Komitetit Drejtues për Instrumentin për Reforma dhe Rritje Ekonomike (KD i IR);
 - 1.2. Komiteti Punues për Integrim Evropian (në tekstin e mëtejshëm, KPIE), i cili gjithashtu vepron në cilësinë e Komitetit Zbatues të Instrumentit për Reforma dhe Rritje Ekonomike (në tekstin e mëtejshëm, KZ i IR); dhe
 - 1.3. Komiteti Monitorues për Bashkëpunim për Zhvillim (në tekstin e mëtejshëm, KMBZH).

Neni 17

Këshilli Ministror për Integrim Evropian

1. KMIE vepron në cilësinë e Komitetit Drejtues të Instrumentit për Reforma dhe Rritje Ekonomike.
2. Në këtë kapacitet, KMIE ushtron funksionin e ofrimit të drejtimit të përgjithshëm në nivelin më të lartë politik për IR, përfshirë RA të IR, dhe atë të mbikëqyrjes së zbatimit, përfshirë lidhur me kushtet e përgjithshme për mbështetje në kuadër të këtij instrumenti.
3. Në këtë kapacitet, KMIE ushtron të njëjtat funksione sikur ato lidhur me procesin e integritimit në Bashkimin Evropian (në tekstin e mëtejshëm, BE), siç përcaktohet në nenin 2 të Vendimit të Qeverisë nr. 03/06, të datës 13.04.2021.
4. KMIE shqyrton dhe i rekomandon Qeverisë për miratim Listën e Projekteve Infrastrukturore, aplikimet për projekte të financuara nga fondet e ofruara nga BE përmes Instrumentit për Asistencë të Para-Anëtarësimit (IPA) dhe Kornizës së Investimeve për Ballkanin Perëndimor (WBIF), përfshirë projektet e investimeve të financuara në kuadër të IR.
5. Në këtë kapacitet, KMIE ka të njëjtën përbërje siç përcaktohet në nenin 2 të Vendimit të Qeverisë nr. 03/06, të datës 13.04.2021. Në mbledhjet e tij marrin pjesë edhe pjesëmarrës të tjerë, siç përcaktohet në të njëjtin nen. Ai funksionon siç përcaktohet në të njëjtin nen.

Komiteti Punues për Integrim Evropian, gjithashtu në cilësinë e Komitetit Zbatues të Instrumentit për Reforma dhe Rritje Ekonomike

1. KPIE është strukturë koordinuese ndërinstitucionale në nivelin e Sekretarëve të Përgjithshëm të Qeverisë dhe menaxherëve të tjerë të lartë në shërbimin civil, të cilët, brenda fushëveprimit të funksioneve dhe të drejtave të tyre, sigurojnë bashkëpunimin ndërmjet ministrive dhe institucioneve të tjera shtetërore për zbatimin e IR, përfshirë AR të IR.
2. KPIE ushtron të njëjtat funksione sikur ato lidhur me procesin e integrimit në BE, siç përcaktohet në nenin 3 të Vendimit të Qeverisë nr. 03/06, të datës 13.04.2021.
3. KPIE ka të njëjtën përbërje siç përcaktohet në nenin 3 të Vendimit të Qeverisë nr. 03/06, të datës 13.04.2021. Në mbledhjet e tij marrin pjesë edhe pjesëmarrës të tjerë, siç përcaktohet në të njëjtin nen. Ai funksionon siç përcaktohet në të njëjtin nen.
4. KPIE gjithashtu vepron në cilësinë e Komitetit Zbatues të Instrumentit për Reforma dhe Rritje Ekonomike. Në këtë kapacitet, ai vepron si strukturë koordinuese e IR në nivel sektorial. Në këtë kapacitet, ai vepron në nivelin e drejtorëve të departamenteve, të cilët, brenda fushëveprimit të funksioneve dhe mandatit të tyre, koordinojnë aktivitetet e rregullta në fushat përkatëse të politikave për zbatimin e mbështetjes së BE-së për Kosovën përmes IR, përfshirë zbatimin e AR të IR.
5. Në cilësinë e KZ të IR, KPIE ushtron këto funksione:
 - 5.1. Diskuton mbi zbatimin të AR të IR dhe arritjen e objektivave të IR, përfshirë identifikimin e sfidave dhe adresimin e tyre, si dhe nxjerrjen e rekomandimeve për institucionet zbatuese, KK të IR dhe KD të IR;
 - 5.2. Monitoron zbatimin e AR të IR dhe arritjen e objektivave të IR përmes Planit të Punës për zbatimin e AR të IR, përfshirë përmes përditësimit të rregullt dhe përcjelljes së zbatimit të tij, dhe diskuton, sipas relevancës, të udhëzimeve për monitorim dhe raportim;
 - 5.3. Diskuton mbi zbatimin e AR të IR në përputhje me rregullat në fuqi dhe raportimin mbi këtë, përkatësisht kontrollin, verifikimin dhe auditimin, parandalimin e financimit të dyfishtë, dhe zbulimin e parandalimit të parregullsisë, mashtrimit, korrupsionit e konfliktit të interesit, që ndikojnë në interesat financiare të BE-së, si dhe nxjerr rekomandimeve për institucionet zbatuese, KK të IR dhe KD të IR;
 - 5.4. Koordinon dhe lehtëson raportimin e rregullt të KE mbi të gjitha aspektet e IR, përfshirë AR të IR, si dhe diskuton raportet përkatëse, me qëllim të sigurimit të zbatimit të duhur të hapave të reformave dhe arritjes së këtyre objektivave;
 - 5.5. Mbështet dialogun e politikave të nivelit të lartë në kuadër të IR përmes diskutimit të përgatitjeve për mbledhjet e KM të IR – përfshirë përfshirjen në të të organizatave të shoqërisë civile, organizatave që përfaqësojnë sektorin privat, partnerëve socialë dhe autoriteteve lokale, sipas relevancës, si dhe të partnerëve për zhvillim dhe institucioneve financiare ndërkombëtare, sipas nevojës – si dhe përmes diskutimit dhe adresimit të vendimeve dhe rekomandimeve të tyre dhe monitorimit të zbatimit të tyre;
 - 5.6. Diskuton mbi zbatimin e PKP të RA të IR, përfshirë masat korrigjuese, si dhe nxjerr rekomandime për institucionet zbatuese, KK të IR dhe KD të IR.

6. KPIE ka këtë përbërje:

- 6.1. Sekretari i Përgjithshëm i ZKM-së, Kryesues;
 - 6.2. Sekretarët e Përgjithshëm të ministrive të përfshira në IR, anëtarë;
 - 6.3. Përfaqësues të ZKM/DIE si institucioni kryesor kombëtar koordinues për IR, dhe të DIEKP-ve të ministrive të përfshira në IR, anëtarë;
 - 6.4. Drejtorët e departamenteve të institucioneve përgjegjëse për zbatimin e AR të IR që janë përgjegjëse për zbatimin e hapave të reformave, anëtarë;
 - 6.5. Drejtori i NJQH-së së ministrisë përgjegjëse për financat, anëtar;
 - 6.6. Drejtori i Thesarit dhe Drejtori i Departamentit të Buxhetit, të ministrisë përgjegjëse për financa, anëtarë.
7. Varësisht nga agenda, Kryesuesi mund të ftojë përfaqësues të institucioneve të tjera për të marrë pjesë në mbledhje.
8. Varësisht nga agenda, Kryesuesi mund të ftojë përfaqësues të BE-së, si dhe të organizatave të shoqërisë civile, organizatave që përfaqësojnë sektorin privat, të partnerëve socialë dhe të autoriteteve lokale, partnerëve për zhvillim, institucioneve financiare ndërkombëtare, dhe ekspertë, sipas nevojës, për të marrë pjesë në takime.
9. KPIE, përfshirë në cilësinë e KZ të IR, mban mbledhje të paktën një herë në muaj, me ftesë të Kryesuesit.

Neni 19

Komiteti Monitorues për Bashkëpunim për Zhvillim

1. Komiteti Monitorues për Bashkëpunim për Zhvillim është strukturë koordinuese ndërinstitucionale në nivelin e drejtorëve të departamenteve dhe zyrtarëve të tjerë të shërbimit civil në nivel profesional, përgjegjës për koordinimin e fondeve të BE-së dhe fondeve të partnerëve të tjerë për zhvillim. Qëllimi i tij është të mbështesë zbatimin e detyrimeve të Republikës së Kosovës, siç parashikohet në nenin 125 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe nenet 6 dhe 52 të Marrëveshjes Kornizë për IPA III.
2. KMBZH kryen këto përgjegjësi dhe detyra:
 - 2.1. Diskuton mbi ndërlidhjen e fondeve të BE-së dhe partnerëve për zhvillim me procesin e integritetit evropian dhe nxjerr rekomandime;
 - 2.2. Diskuton mbi dhe shqyrton kalendarin e programimit për IPA, WBIF dhe instrumentet e tjera të ofruara nga BE dhe partnerët për zhvillim;
 - 2.3. Diskuton mbi sfidat e identifikuar gjatë zbatimit të fondeve të BE-së dhe partnerëve për zhvillimin dhe nxjerr rekomandime për zgjidhje;
 - 2.4. Diskuton mbi raportin vjetor të zbatimit të IPA para dorëzimit të tij në BE, si dhe mbi raportin vjetor të zbatimit të fondeve të partnerëve për zhvillim në Republikën e Kosovës;
 - 2.5. Diskuton mbi përgatitjet për mbledhjet me BE-në në kuadër të Komitetit të Përbashkët të Monitorimit për IPA dhe mbledhje të tjera të planifikuara me partnerët për zhvillim sipas marrëveshjeve ndërkombëtare;
 - 2.6. Nxjerr rekomandime për KZ të IR dhe KMIE-në mbi zbatimin e projekteve të financuara nga BE dhe partnerët për zhvillim.

3. KMBZH ka këtë përbërje:

- 3.1. Drejtori i ZBZH, Kryesues;
 - 3.2. Drejtori i ZKPSA, anëtar;
 - 3.3. Drejtori i ZKP, anëtar;
 - 3.4. Drejtori i ZKETB, anëtar;
 - 3.5. Drejtori i ZPoS, anëtar;
 - 3.6. Drejtorët e DIEKP-ve në ministritë e linjës dhe zyrtarët përgjegjës për koordinimin e fondeve të BE-së e të partnerëve për zhvillim në institucione të tjera.
4. Varësisht nga agjenda, Kryesuesi mund të ftojë përfaqësues të ministrive të linjës për të marrë pjesë në takime.
5. Varësisht nga agjenda, Kryesuesi mund të ftojë përfaqësues të institucioneve të tjera për të marrë pjesë në takime.
6. Varësisht nga agjenda, Kryesuesi mund të ftojë përfaqësues të BE-së, si dhe të organizatave të shoqërisë civile, organizatave që përfaqësojnë sektorin privat, të partnerëve socialë dhe të autoriteteve lokale, partnerëve për zhvillim, institucioneve financiare ndërkombëtare dhe ekspertë, sipas nevojës, për të marrë pjesë në takime.
7. KMBZH mbledhet të paktën një herë në tre muaj, me ftesë të Kryesuesit.

Neni 20

Sekretariatet

1. Strukturat koordinuese ndërinstitutionale të rregulluara nga ky vendim mbështeten në funksionimin e tyre nga Sekretariatet e tyre.
2. Secili Sekretariat është përgjegjës për organizimin e punës së strukturës përkatëse dhe kryen këto detyra:
 - 2.1. Përgatit dhe shpërndan agjendat dhe materialet e tjera të mbledhjeve;
 - 2.2. Organizon mbledhjet dhe ofron mbështetje teknike gjatë mbledhjeve;
 - 2.3. Përgatit procesverbalet, konkluzionet dhe materialet e tjera të mbledhjeve dhe ua shpërndan ato anëtarëve dhe pjesëmarrësve në mbledhje, si dhe palëve të tjera relevante;
 - 2.4. I ofron mbështetje strukturës përkatëse në kryerjen e funksioneve të saj;
 - 2.5. Monitoron zbatimin e konkluzioneve të strukturës përkatëse dhe të vendimeve të Qeverisë për zbatimin e tyre, dhe, me kërkesë të saj, ia paraqet rezultatet e monitorimit për diskutime të mëtejshme dhe për ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme.
3. Sekretariati i KMIE-së, i cili vepron edhe në cilësinë e KD të IR, është ZKM, përkatësisht ZKPSA, për çështjet që lidhen me reformat e politikave, dhe ZBZH, për çështjet që lidhen me fondet e BE-së dhe projektet investuese.
4. Anëtarët e Sekretariatit të KM të IR nga pala e Qeverisë janë nga ZKM, përkatësisht nga ZKPSA, për çështjet që lidhen me reformat e politikave, dhe nga ZBZH, për çështjet që lidhen me fondet e BE-së dhe projektet investuese. Sekretariati i KM të IR organizon takime të rregullta në nivel teknik për të përgatitur mbledhjet e KM të IR dhe për të diskutuar të gjitha çështjet relevante që lidhen me IR.

5. Sekretariati i KPIE-së, i cili vepron edhe në cilësinë e KZ të IR, është ZKM, përkatësisht zyrat që mbulojnë fushat përkatëse të politikave: ZKP, ZKETB dhe ZPoS. Ai kryen detyrat e tij, sipas nevojës, në bashkëpunim me ZKPSA dhe ZBZH.
6. Sekretariati i KMBZH është ZKM, përkatësisht ZBZH.

Neni 21

Dispozitat e tjera

1. Në rast të ndonjë ndryshimi në strukturat e çfarëdo institucioni të përfshirë në tërë temën e që rregullon ku vendim, kjo nuk ndikon në natyrën detyruese të këtij vendimi. Të gjitha përgjegjësitë e parapara këtu kryhen nga institucionet përkatëse në përputhje me vendimet përkatëse të Qeverisë mbi mandatin ligjor dhe fushëveprimin e përgjegjësive të institucioneve të tilla.
2. Qeveria, në konsultim me KE-në dhe subjektet e tjera të prekura, mund të vendosë ta amendamentojë këtë vendim, sipas nevojës, për të përshtatur ndryshimet e mundshme në të ardhmen në struktura të tilla. Amendamente të tilla bëhen duke ndjekur të njëjtën procedurë të ndjekur për miratimin e tij për herë të parë.

Neni 22

Shfuqizimi


Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohen këto dispozita: pikat 2.5.5, 2.5.6, 3.4.6, 3.4.7, 3.4.8 dhe 3.4.9 të Vendimit të Qeverisë nr. 04/12, të datës 09.07.2020.

Neni 23

Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

Shtojcë: Përgjegjësitë institucionale për zbatimin AR të IR dhe raportimin për këtë

AR e IR		Institucionet përgjegjëse
<i>Koordinimi</i>		
Koordinimi i monitorimit dhe raportimit		Zyra e Kryeministrit (ZKM)
Koordinatori Kombëtar		Zyra e Kryeministrit (ZKM)
Dorëzimi i kërkesave për lëshimin e fondeve		Zyra e Kryeministrit (ZKM)
Projektet investuese		Zyra e Kryeministrit (ZKM)
<i>Fushat e politikave dhe nënfushat/komponentët</i>		<i>Institucionet përgjegjëse</i>
1. Qeverisja, reforma e administratës publike dhe menaxhimi i financave publike	1.1. Reforma e administratës publike	Ministria e Digjitalizimit dhe Administratës Publike (MDAP) Ministria e Financave (MF)
	1.2. Menaxhimi i financave publike	Ministria e Financave (MF) Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRRPP) Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Kuvendi Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA)
2. Tranzicioni i gjelbër dhe ai digjital	2.1. Digjitalizimi i shërbimeve publike dhe infrastrukturave	Zyra e Kryeministrit (ZKM) Ministria e Digjitalizimit dhe Administratës Publike (MDAP) Ministria e Ekonomisë (ME) Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) Ministria e Financave (MF) Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit (MINTI) Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP) Kuvendi
	2.2. Siguria kibernetike	Ministria e Digjitalizimit dhe Administratës Publike (MDAP) Kuvendi
	2.3. Reformat e tregut	Ministria e Ekonomisë (ME) Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) Zyra e Kryeministrit (ZKM) Ministria e Financave (MF) Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit (MINTI) Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Kosovës (KOSTT)

		Kompania Kosovare për Furnizim me Energji (KESCO) Sistemi i Kosovës për Shpërndarjen e Energjisë (KEDS) Korporata Energjetike e Kosovës (KEK)
	2.4. Politikat e dekarbonizimit	Ministria e Ekonomisë (ME) Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) Ministria për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare (MPFVLÇ)
	2.5. Shpërndarja e burimeve të ripërtëritshme të energjisë	Ministria e Ekonomisë (ME) Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Kosovës (KOSTT) Sistemi i Kosovës për Shpërndarjen e Energjisë (KEDS) Komunat
	2.6. Eficienca e energjisë	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) Ministria e Ekonomisë (ME) Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë (FKEE) Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) Termokosi Komunat
3. Zhvillimi i sektorit privat dhe mjedisi afarist	3.1. Mjedisi afarist	Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit (MINTI) Ministria e Financave (MF) Zyra e Kryeministrit (ZKM) Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës (MPJD) Ministria e Drejtësisë (MD) Kuvendi Komisioni për Ndihmë Shtetërore (KNSH) Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) Ndërmarrjet Publike (NP-të)
	3.2. Qasja në financa	Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit (MINTI) Ministria e Financave (MF) Banka Qendrore e Kosovës (BQK) Kuvendi Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK)
4. Zhvillimi dhe ruajtja e kapitalit njerëzor	4.1. Arsimi	Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH) Komunat
	4.2. Tregu i punës	Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH) Ministria për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare (MPFVLÇ)

		Kuvendi
5. Bazat e aderimit në BE / Sundimi i ligjit	5.1. Gjyqësori	Ministria e Drejtësisë (MD) Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (APK)
	5.2. Lufta kundër korrupsionit	Zyra e Kryeministrit (ZKM) Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (APK) Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK)
	5.3. Lufta kundër krimit të organizuar	Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) Ministria e Drejtësisë (MD) Ministria e Financave (MF) Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) Koordinatori Kombëtar për Krime Ekonomike (KKKE) Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës
	5.4. Të drejtat themelore	Zyra e Kryeministrit (ZKM) Ministria e Drejtësisë (MD) Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK)
	5.5. Demokracia	Kuvendi
	5.6. Politika e vizave	Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës (MPJD) Ministria e Punëve të Brendshme (MPB)